

Nr. 718/13 Prot.

Vlorë më, 11.11.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

VENDIM
Nr. 73 datë 20.11.2024

PËR ÇELJEN E PROCEDURËS PËR VETËKANDIDIM PËR ANËTAR TË
KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR STUDENTOR (KIZS)

Në mbështetje të nenit 38, 39, pika 12 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, nenit 6 pika 3, nenit 8 të Rregullores "Për zgjedhjen e këshillave studentorë në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, shkresës 2447, prot, datë 19.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të radhës datë 20.11.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë çeljen e procedurës për vetkandidim për anëtar të Komisionit Institucional Zgjedhor studentor (KIZS), në UV.
2. (KIZS) përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, 1 (një) përfaqësues për cdo fakultet. Fakulteti që ka numrin më të madh të studentëve do të ketë 2 (dy) përfaqësues, të gjithë me të drejtë vote.
3. Periudha kohore e pranimit të vetëkandidimeve zgjat nga data 21.11.2024 deri më 27.11.2024.
4. Vetëkandidimi dorëzohet në Zyrën e Protokollit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe do të administrohen nga sekretaria e Senatit Akademik.
5. Ngarkohet Drejtorja e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore për shpallje në faqen Web të vendimit dhe bërjen e njoftimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliqaj